



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:254513

Datë: 29.11.2023

Numri i dokumentit: 05171966

C.nr.2271/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.L., nga F..., kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në P..., përfaqësuar nga M.K. sipas autorizimit, për pagat e papaguara, në shqyrtimin kryesor-publik të mbajtur me datë 29.11.2023, ndërsa me datë 22.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET SI E THEMELTË kërkesëpadia e paditësit Xh.L., nga F..., dhe DETYROHET e paditura Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të pagave të papaguara për periudhën 08.07.2017 deri më 22.06.2018, t'ia paguajë pagën neto shumë prej 5,811.81€, në emër të përvojës së punës shumë prej 484.33 euro, në emër të kontributit nga punëdhënësi shumë prej 376.20 euro, dhe në emër të kamatës shumë prej 2,908.24 euro, të gjitha në afat 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjyqimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi në seancën e datës 29.11.2023 dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se meqenëse paditësja ka shfuqizuar vendimin e saj me të cilin është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe më ka kthyer në pozitën e punës si oficer doganor, dhe pas procedurave të zhvilluara e njëjta nuk ka kompensuar pagat për kohën sa ka qenë e ndërprerë

marrëdhënia e punës, duke më shkaktuar dëm material. Tutje ka shtuar se bëjë precizimin e kërkesëpadisë në kuptimin e lartësisë së kërkesës, ashtu që ka kërkuar të detyrohet e paditura që në emër të pagave të papaguara për periudhën 08.07.2017 e deri me datë 22.06.2018, t'ia paguaj në emër të pagës neto shumën prej 5,811.81 euro, në emër të përvojës së punës shumën prej 484.33 euro, në emër të kontributit nga punëdhënësi shumën prej 376.20 euro dhe në emër të kamatës shumën prej 2,908.24 euro. Andaj nga të cekurat më lartë ka kërkuar nga gjykata që kërkesë padinë e paditësit të aprovoj në tërësi si të themeltë.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës, me përgjigje në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë, e paditësit pasi që nuk mund ta mbështesë padinë e tij me asnjë provë. Tutje ka shtuar se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ka qenë i ligjshëm pasi që drejtori i përgjithshëm i Doganës me rastin e ndërprerjes së punës është bazuar në aktgjykimin penal nr. ... me të cilin paditësi ka qenë i dënuar me nëntë muaj burgim, dhe kjo ka qenë premisë ligjore për marrjen e këtij vendimi. Duke u bazuar nga këto të lartë cekura ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 29.11.2023, bëri administrimin e provave me leximin e: aktgjykimi ... i datës 08.06.2017, ... i datës 02.12.2016, kontrata e punës nr..., vendimi numër ... i datës 11.06.2018, ankesa numër 06.07.2018, rekomandimi numër i datës 27.07.2018, vendimi numër i datës 06.08.2018, vendimi numër ... i datës 02.03.2016, aktgjykimi PML.nr.... i datës 10.04.2018, vendimi numër i datës 31.07.2017, ekspertiza financiare e datës 26.06.2023.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Ne mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendimin nr..... i datës 31.07.2017.

Po ashtu në mes palëve nuk ishte kontestuese se paditësi është rikthyer në vendin e punës si oficer doganor me vendimin nr..... i datës 11.06.2018.

Mirëpo në mes të palëve ndërgjyqëse kontestuese ishte se a i takonin pagat për periudhën kontestuese 08.08.2017 e deri me 22.06.2018, sa ka zgjatur ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Gjykata ka vendosur ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar t'i paguhen pagat e papaguara për periudhën gjatë të cilës paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, duke e detyruar të paditurën që t'ia njoh shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata vendosi që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, pasi që baza juridike e kërkesëpadiës së paditësit është krijuar me vendimin e Doganës së Kosovës nr.... të datës 11.06.2018, ku me të cilin vendim rikthehet në punë paditësi si oficer doganor.

Sipas dispozitës së nenit 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), parashihet se “Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë t'ia kompensoi, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”, ndërsa në dispozitën e nenit 140 parashihet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”.

Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës gjykata ja ka falur në tërësi besimin ekspertizës financiare të datës 26.06.2023, të punuar nga eksperti financiar A.L., ngase e njëjta është punuar në mënyrë profesionale dhe është vlerësuar mjaftë bindëse për gjykatën, sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës së paditësit. Prandaj, nga të lartcekurat

gjkata vendosi që paditësi të kompensohet në lartësinë e përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimit e të paditurës gjykata nuk i vlerësoj si të rëndësishme për të vendosur ndryshe.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 450 të LPK, ashtu që secila pale në procedure i bartë shpenzimet e veta procedural, pasi që nuk ka pasur kërkesë për shpenzimet nga asnjëra palë.

Mbi bazën e të dhënave si me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2271/2017, dt. 22.12.2023

Përparim Zeka

Gjyqtar

KËSHILLË JURDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së tij, përmes kësaj gjykate për Gjykatën Apelit Prishtinë.